

## **KONKURS DHE UDHËZIME**

**DEPARTAMENTI I DREJTËSISË DHE  
INCIATIVAVE TË SHOQËRISË CIVILE  
2009-2010 PROGRAMI I GRANTEVE**

## **PROGRAMI I GRANTEVE 2009-2010**

### **Konkursi dhe Udhëzimet**

1. ICMP-ja është e lumtur që është në gjendje të ofrojë grante të vogla për përkrahje të projekteve të shoqatave familjare në trajtimin e fatit të të dashurve të tyre të zhdukur, kidnapuar, burgosur, rrëmbyer dhe të larguar. Ky qëllim kryesor I Departamentit të Drejtësisë dhe Iniciativave të Shoqërisë Civile, është për të inkurajuar angazhimin e efektshëm të anëtarëve të familjeve të të zhdukurve në përfaqesimin e interesave të tyre dhe avokimin e aktiviteteve në drejtim të zgjidhjes më të shpejtë të çështjes së personave të zhdukur. Qëllimi i këtij konkursi për grante, është ofrimi i përkrahjes së aktiviteteve të shoqatave familjare të cilat kanë të bëjnë me trajtimin e çështjes së personave të zhdukur për shkak të konflikteve në rajon. ICMP punon me të gjitha grupet etnike/religjioze të cilat kërkojnë më të dashurit e tyre si pasojë e konflikteve nga 1991-1999, të cilat prekën Republikën e Kroacisë (HR), Bosnjen dhe Hercegovinën (BiH), Republikën e Serbisë (SRB), Republikën e Malit të Zi (MNE), dhe Kosovën.
2. ICMP ka hartuar një strategji të re e cila ndikon në programet e saj të granteve. Në të vërtetë, për të siguruar vetë qëndrueshmërinë e mekanizmave dhe strukturave të cilat janë krijuar si pasojë e përpjekjeve të shoqatave të familjeve, dhe për të siguruar avokim të qëndrueshëm, ndërgjegjsim dhe angazhim të publikut për çështjen e personave të zhdukur, ICMP po e kthen vëmendjen tek avancimi I aktiviteteve e koalicioneve të reja duke përfshirë të dyja, shoqatat ekzistuese familjare dhe partneret e ri të shoqatave familjare. Nderkohe që prania e komunitetit ndërkombëtarë në rajon është duke rënë dukshëm, bashkë me fondet në dispozicion, është qenësore për shoqatat familjare të personave të zhdukur për tu bashkuar me organizatat e tjera relevante, dhe të sigurojnë qëndrueshmërinë e tyre në planin afatgjatë. Shpresohet se ky koalicion I ri do të rezultojë në përpjekjet e kombinuara dhe zhvillimin e metodave të reja dhe qasjeve për të trajtuar çështjen e personave të zhdukur në kohën që vjen, duke u bazuar në interesat e përbashkëta..
3. Në vazhdim të ndihmës për krijimin e strukturave të qëndrueshme të shoqërisë civile, të cilat do të vazhdonin punën për çështjen e personave të zhdukur, ICMP synon krijimin e modeleve të reja dhe universale të kujtimit të cilat do të tejkalojnë paragjykimet për shkatërrimet në të kaluarën dhe do të kontribuonin një kujtesë kulturore të paanueshme më gjerë. Kjo do të arrihej përmes nxitjes së dialogut midis anëtarëve të mbijetuar të familjeve të personave të zhdukur, OJQ-ve për të drejtat e njeriut, me qëllim të angazhimit të tyre aktiv në lobim dhe avokim për të drejtat e anëtarëve të familjeve të personave të zhdukur dhe për të nxitur aktivitetet e përbashkëta (tryezat e rrumbullaketa, ekspozitat, dokumentarët, shfaqjet etj.). Është me rëndësi të madhe që sinergia e organizatave jo-fitimprurëse për të drejtat e njeriut, përfaqësuesve qeveritarë dhe anëtarëve të shoqërisë civile të realizohet përmes këtij projekti. Pjesmarrja domethënëse e shoqatave familjare të të zhdukurve në krijimin dhe zbatimin e këtij procesi është thelbësore.

### **I. QËLLIMET E PËRGJITHSHME**

4. Qëllimi I përgjithshëm I përfshirjes së partnerëve të rinj, është përkrahja për Shoqatat e Familjeve të Personave të Zhdukur (SHF) në rajon për hartimin e projekteve të reja të përbashkëta, programeve dhe koalicioneve me anëtarët e shoqërisë së gjerë civile dhe rritja e ndërgjegjesimit dhe angazhimit të publikut për çështjen e personave të zhdukur.

#### **1. Qëllimet specifike**

- Ndërgjegjsimi I publikut për çështjen e personave të zhdukur dhe proceset.

- Forcimi I kapaciteteve të Shoqatave të Familjeve të personave të zhdukur duke punuar për së afërmi me organizatat lokale të Shoqërisë Civile për të kontribuar në mënyrë efektive në proceset e drejtësisë në tranzicion, paqes mirëkuptimit të përbashkët dhe ndërgjegjesimit në lidhje me çështjen e personave të zhdukur.
- Të përkrahë Shoqatat Familjare të Personave të zhdukur për të punuar për së afërmi me qeverinë dhe institucionet shtetërore për të avokuar për të drejtat e tyre.
- Forcimi I kapacitetetve të Shoqatave Familjare të personave të zhdukur për të punuar për së afërmi me sistemin lokal dhe shtetëror të drejtësisë për tu marrë me gjykimet për krimet e luftës, përndjekjen, të drejtat etj.

## 2. Rrezultatet e pritshme në përgjithësi

- Rritja e ndërgjegjesimit të publikut të gjerë në lidhje me çështjen e personave të zhdukur.
- Ngritja e kapaciteteve të Shoqatave Familjare të personave të zhdukur për tu angazhuar në dialog për politikatat me qeveritë e ndryshme Kombëtare/entiteteve/lokale, në lidhje me çështjen e personave të zhdukur.
- Ngjirtja e ndërgjegjesimit dhe përkrahja nga Qeveritë shtetërore dhe strukturat e qeverisjes vendore për projektet e zbatuara nga Shoqatat Familjare të personave të zhdukur dhe partneret e tyre.
- Rritja e prekshme e diskutimeve publike në sektorin e Iniciativave të Shoqërisë Civile (CSS) rreth çështjes së personave të zhdukur.

## II. LLOJET E PËRKRAHJEVE PËR PROJEKTE

5. Projekti duhet të përmbajë seri aktivitetesh të cilat duhet të arrijnë qëllime shumë specifike dhe të arsyeshme, të cilat qartësisht e kanë të përcaktuar përfundimin e pritshëm. Përparësi do ti jepet projekteve të cilat përfshijnë partnerë tjerë (si organizatat jo fitimprurëse për të drejtat e njeriut dhe strukturat qeveritare, partnerë nga sektori privat, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të, asociacionet etj.) dhe/ose të cilat paraqesin aktivitete inkurajuese të orientuara në më shumë se një bashkësi etnike.
6. Aktivitetet duhet të jenë në përputhje me njërin ose tjetrën apo të dyja përparësi të ICMP-së. Asociacionet mund të aplikojnë për një nga këto lloje të prkrahjes: Projektet afatgjatë dhe projektet afatshkurtër.
7. Asociacionet inkurajohen të propozojnë aktivitete të përbashkëta të dy ose më shumë shoqatave familjare të së paku dy bashkesive të ndryshme etnike, duke përfshirë rajone të veçanta gjeografike etnitete të ndryshme gjeografike ose vende të cilat kanë interesa të përbashkëta. Asociacionet, gjithashtu duhet të propozojnë bashkëpunim të sektorëve të ndryshëm të shoqërisë, si qeveritë, komuniteti ndërkombëtar, sektori privat dhe OJQ ose asociacione te tjera.
8. Në rast të projekteve të përbashkëta, shpenzimet kryesore të pjesmarrësve në projekt, do të mbulohen në bazë të punës së **asociacioneve** të përfshira, si dhe në përputhje me politikatat për përkrahje thelbësore financiare të ICMP-së. Gjithsesi, a do të zbatohen aktivitetet e projektit nga SHF dhe agjensi qeveritare/sector privat, ICMP-ja do të mbulojë vetëm shpenzimet kryesore të SHF. Projektet të cilat zotojnë fonde nga donatorët tjerë (përpos KNKK) do të kenë përparësi më të lartë për përkrahje.

### i) **Projektet afatgjata**

- Kush mund të aplikojë: Dy ose më shumë shoqata ligjërish të regjistruara të familjeve të personave të zhdukur me origjinë të ndryshme etnike; një asociacion I familjeve të personave të zhdukur dhe një ose më shumë organizatave te tjera jo qeveritare.
- Kohëzgjatja: projekte 4 - 6 mujore duke filluar nga Dhjetori 2009.

- Fondet në dispozicion: 5 projekte 10,000 BAM/5,000 EUR.
- Si të aplikoni: parashtroni projekt propozim sipas udhëzimeve të ICMP për propozim Projekte, me segmente e aktiviteteve për secilin partner. Projekt propozimet jashtë udhëzimeve të ICMP nuk do të merren parasysh.

**ii) Përkrahja afatshkurtër**

- Kush mund të aplikojë: Dy ose më shumë shoqata ligjërish të regjistruara të familjeve të personave të zhdukur me origjinë të ndryshme etnike; asociacion I familjeve të personave të zhdukur dhe një ose më shumë organizatave të tjera jo qeveritare.
- Kohëzgjatja: një muaj ose më pak për ngjarje të njëhershme.
- Shuma maksimale që mund të kërkohet: 4,000 BAM/2,000 EUR
- Si të aplikoni: Ju lutemi kontaktoni ICMP për formularin për aplikim për përkrahje afatshkurtër. Projekt propozimet jashtë udhëzimeve të ICMP nuk do të merren parasysh.

### **III. AKTIVITETET ME PËRPARESI**

9. Të gjitha projektet e parashtruara duhet të trajtojnë problem ose probleme të veçanta që kanë të bëjnë me çështjen e personave të zhdukur dhe duhet të jenë në këto fusha me përparesi:

**1) Forcimi I kapaciteteve të shoqatave familjare dhe strukturat e tyre të përbashkëta për tu bërë avokate kombëtare, rajonale dhe globale të çështjes**

10. Qëllimet përfshijnë zhvillimin e shkathtësive të nevojshme për të siguruar financim të qëndrueshëm nga burime të ndryshme në aspektin afatgjatë, zhvillimin e strukturave rajonale në mënyrë që të sigurojë zë të unfikuar për çështjen e personave të zhdukur, të inkurajojë bashkëpunimin më të madh midis grupeve të ndryshme religjioze/etnike në avokimin e përbashkët të çështjes dhe zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

11. Aktivitetet mund të përfshijnë p.sh aktivitete avokuese, ofrim edukimi dhe informimi për procesin e zhvarrimeve dhe identifikimeve si dhe punën e shoqatave të familjeve, aktivitetet për ngritjen e ndërgjegjësimit, ose aktivitete tjera të cilat do të përfshinin çështjet tej etnike/shtetërore, fushat ndër etnike si shqetësim I përbashkët I grupeve të prekura etj. ICMP inkurajon fuqishem aktivitetet të cilat do të përfshinin pjesmarrjen e të rinjve dhe prodhimet kulturore.

**2) Adoptimi I modeleve inovative dhe shpresëdhënëse të kujtesës dhe përkujtimin**

12. Qëllimet janë inkurajimi I hartimit të modeleve inovative, shpresëdhënëse dhe gjerësisht të pranueshme, të modeleve të kujtesës, të cilat do të tejkalonin paragjykimet për shkatërrimet në të kaluarën në drejtim të kujtesës kulturore, gjerësisht të pranueshme. Pjesëmarrja domethënëse e viktimave – të mbijeturave, si në krijimin ashtu edhe në zbatimin e mekanizmave të caktuar, është thelbësore. Është me rëndësi të veçantë realizimi në këtë projekt I sinergjisë së organizatave jo fitimprurëse për të drejtat e njeriut, përfaqësuesve të qeverive dhe anëtarëve të shoqërisë civile. Shembull aktivitetesh mund të përfshijnë hapjen e dialogut midis të viktimave/të mbijeturave, anëtarëve të shquar të shoqërisë civile dhe intelektualëve me qëllim të angazhimit aktiv të tyre në lobim dhe avokim për të drejtat e viktimave/të mbijeturave, prodhimet e përbashkëta kulturore (ekspozita, dokumentarë, shfaqje etj.), partneriteti me OJQ-të, institucionet qeveritare, sektorin privat etj., përkujtimin e datave, ndërkombetarisht të pranuar të rëndësishme për çështjen e personave të zhdukur (30 gushti, 10 shtatori etj).

#### **IV. E DREJTA E SHOVRTIMIT TË MATERIALEVE TË SHYTPURA/MULTIMEDIAS**

13. ICMP kërkon të drejtën parësore për shqyrtimin e çdo dokumenti, broshure, ëeb faqeje, dokumentari, fletushke të prodhuarar si rezultat I granit.

#### **V. KRITERET PËR PËRKRAHJE FINANCIARE**

14. Projekt propozimet do të vlerësohen në bazë të përputhshmërisë së tyre me përparësitë e granteve të ICMP.
15. Faktorët e tjerë të cilët do të merren parasysh përfshijnë:
- Ndikimin e shoqatës dhe projektit në bashkësi, përfshirë këtu edhe marrëdhëniet me qeverinë, OJQ-të tjera dhe sektorin privat;
  - Rezultatet e aktiviteteve në projektet e mëparshme;
  - Qasja e re ose idetë për aktivitete të reja në project;
  - Pjesëmarrja në rrjetet e tjera të OJQ-ve;
  - Përvojat e mëparshme me partneritet ose projekte të përbashkëta;
  - Ndarja e qartë e detyrave midis partnerëve zbatues;
  - Pëputhshmëria midis deklaratës mbi misionin, qëllimet dhe aktivitetet e propozuara;
  - Burimet e tjera të përkrahjes financiare ose të brendshme.

#### **VI. KËRKESAT E PAPRANUESHME**

16. Kërkesat për investime kapitale (ndërtesat, mobiljet, pajisjet dhe makinat), rindertimi, pagat ose ndihma direkte humanitare (ushqimi, ilaçet, drutë për ngrohje, rrobat etj.) nuk do të merren parasysh.

#### **VII. KUALIFIKIMI DHE PROCEDURA E APLIKIMIT**

17. Aplikuesit duhet të plotësojnë një numër kriteresh:

**i) Kriteret bazë për Shoqatat e Familjeve të Personave të Zhdukur**

- Përvoja në zbatim të projekteve;
- Shoqatat duhet të jenë ligjrisht të regjistruara;
- Anëtarësia e mjaftueshme për zbatimin e efektshëm të projektit (parashtroni listen e anëtarëve).

**ii) Kriteret bazë të cilat kërkohen për partneret e rinj të Shoqatave Familjare të Personave të Zhdukur**

- Ekspertizë profesionale dhe kualifikim I domosdoshëm për zbatimin e sukseshëm të projektit;
- Shkathtësi organizative dhe mundësi për të zbatuar projekte;
- Metodologji e përshtatshme pune ose qasje në punën me kategoritë e veçanta ose përvojë pune me to;
- Dije ose përvojë pune në lidhje me drejtësinë në tranzicion, të drejtat e njeriut, pajtimin, çështjen e personave të zhdukur ose fusha të ngjashme;
- Besueshmëria në bashkësi (përvojat e mëhershme, të arriturat, projektet, aktivitetet, shpërblimet, përmblimet);

- Përvojë në punë me grupe të ndryshme të caktuara dhe gatishmëri për të punuar nën kushte stresi.

18. Për më tepër, duhet të plotësohen edhe kërkesat në vijim:

- Partnerë të kualifikuar: Dy ose më shumë shoqata të familjeve të personave të zhdukur, ligjërisht të regjistruara të përkatesise së ndryshme etnike, të regjistruara në vendet e ish Jugosllavisë; një shoqatë familjare e personave të zhdukur e regjistruar në një vend të ish Jugosllavisë dhe një ose më shumë organizata të tjera jo qeveritare të regjistruara në vendet e ish Jugosllavisë;
- Projektet e kualifikuara duhet të trajtojnë subjektet në lidhje me çështjen e personave të zhdukur në ish Jugosllavi;
- Propozimet duhet ti përmbahen formatit të kërkuar. Propozimet të cilat nuk korrespondojnë me formën dhe udhëzimet e kërkuara, do të skualifikohen;
- Ju duhet të përgatisni propozimin e shkruar për grant dhe buxhetin, dhe ta dërgoni atë me fax, postë, ose e mail në adresat e poshte-shënuara;
- Pagesat retroactive ose shpenzimet, para fillimit të afatit të caktuar në letër, nuk do të merren parasysh;
- Projektet të cilat tregojnë ndarjen e shpenzimeve, do tu jepet përparësi në përkrahje, që tregojnë para të gatshme, (donacion për punën e shoqatës) ose donacione të brendshme (letër e dhuruar, qeraja e reduktuar, transporti ose shërbimet për shoqatën, shërbimet profesionale/vullnetare – kontabilist, gazetarë, jurist, asistent në kompjuter etj) nga donatorët e tjerë;
- Rinovimi I përkrahjes së mëparshme për grante nuk duhet të jetë automatik, dhe ICMP nuk mban përgjegjësi për shpenzimet para fillimit të kontratës për grante;
- Ju mund të prisni që të kontaktoheni me pyetje përcjellëse ose sqarime në lidhje me propozimin tuaj gjatë procesit të shqyrtimit;
- Nje komision I të punësuarve të ICMP/ose këshilltarëve të jashtëm do të marrë vendim për projektet fituese;
- Të gjithë aplikuesit do ti njoftojmë në të shkruar për vendimin e marrë.

## **VIII. AFATET**

19. Projekt propozimet për përkrahje afatgjatë duhet të parashtrohen për tu marrë parasysh deri me **15 nëntor 2009 në 12:00**. Propozimet e pranuar pas këtij afati, nuk do të shqyrtohen.

20. Propozimet për përkrahje afat shkurtër duhet të parashtrohen së paku 10 ditë para fillimit të aktivitetit dhe do të pranohen në bazë të paraqitjes së nevojës.

21. Projekt propozimet duhet të dërgohen tek:

International Commission on Missing Persons (ICMP)  
Alipašina 45/A  
71000 Sarajevë, Bosnije dhe Hercegovinë  
Tel: + 387 33 218 660 / Fax: + 387 33 203 297

Patricia Pfister  
Kordinatore për Ballkanin Perëndimor  
Departamentit i Drejtësisë dhe Iniciativave të Shoqërisë Civile  
E-mail : [jcsi.grants@ic-mp.org](mailto:jcsi.grants@ic-mp.org)

**Të bashkangjitura:** Forma e Propozimit për Grante (përfshirë edhe buxhetin dhe kornizën logjike), ICMP.JCSI.62.1.alb.doc;  
Politikat për shpenzimet kryesore të ICMP, ICMP.JCSI.63.1.alb.doc;  
Lista e dokumentave që duhet të parashtrihen, ICMP.JCSI.64.1.alb.doc.